

VENDIM
Nr. 571, datë 3.9.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE
EKZISTUESE TË QYTETIT, NDËRTIMI I NYJËS SË RRETHROTULLIMIT LUZ,
SI DHE MBROJTJA NGA PËRMBYTJET E LUMIT ZEZË, TË BASHKISË SË FUSHË
- KRUIJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave ekzistuese të qytetit, ndërtimi i nyjës së rrethrotullimit Luz, si dhe mbrojtja nga përmbytjet e lumit Zezë, të bashkisë së Fushë - Krujës, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Fushë - Krujës dhe pasuritë, përkatësisht, 2000 (dy mijë) m² tokë bujqësore, për zgjerimin e varrezave ekzistuese të qytetit, 5 731 (pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një) m² tokë bujqësore, për ndërtimin e nyjës së rrethrotullimit Luz, dhe 30 (tridhjetë) m² tokë bujqësore e 2 (dy) m² sipërfaqe ndërtese, për mbrojtjen nga përmbytjet e lumit Zezë, të bashkisë Fushë - Krujë, regjistrohen në emër të kësaj bashkie.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumat, si më poshtë vijon:

a) 1 072 000 (një milion e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë, për zgjerimin e varrezave ekzistuese të qytetit;

b) 2 601 874 (dy milionë e gjashtëqind e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë, për ndërtimin e nyjës së rrethrotullimit Luz;

c) 227 460 (dyqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë, për mbrojtjen nga përmbytjet e lumit Zezë, të bashkisë së Fushë -Krujës.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 901 334 (tre milionë e nëntëqind e një mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Fushë - Krujës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Shpenzimet procedurale të përballohen nga bashkia e Fushë - Krujës.

6. Afati i përfundimit të procedurës së shpro-nësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në bashkinë e Fushë - Krujës të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkia e Fushë - Krujës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA EMRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR
PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE TË QYTETIT FUSHË KRUIË**

Nr.	Familja që shpronësohet	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Sip.truallit/m2	Çmimi/lekë/m2	Shpronësim për të mbjellat	Vlera lekë	Dokum. Pronësie
1	Shaban Sali Maloku	1665	248/3-1	2000	952000	120000	1072000	Vërtetim pronësie
	Shuma totale						1 072 000	

**LISTA EMRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR
PËR MBROJTJEN NGA PËRMBYTJA TË LUMIT ZEZË**

Nr.	Familja që shpronësohet	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip.truallit/m2	Sip. ndërtesës/m2	Vlera e truallit	Vlera e ndërtesës lekë/m2	Vlera lekë	Dokum. Pronësie
1	Muhamet Ali Danellari	1664	2/513	30	2	123000	104460	227 460	Vërtetim pronësie
	Shuma totale							227 460	

**LISTA EMRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR
PËR NDËRTIMIN E NYJËS SË RRETHROTULLIMIT**

Nr.	Familja që shpronësohet	Zona Kadastrale Luz	Nr.i pasurisë	Sip/m2	Çmimi	Tokë bujqësore/lekë	Prodhimi/lekë	Vlera e përgjith. lekë	Dokum. Pronësie
1	Kastriot Zef Musteqja	2537	68/35	1305	354	461970	130500	592470	Vërtetim pronësie
2	MarieZef Musteqja	2537	68/37	620	354	219480	62000	281480	Vërtetim pronësie
3	Gjok Zef Musteqja	2537	68/51	709	354	250986	70900	321886	Vërtetim pronësie

4	Leonora Nue Lleshi (Musteqja)	2537	68/39	360	354	127440	36000	163440	
5	Leonora Nue Lleshi (Musteqja)	2537	68/41	240	354	84960	24000	108960	Vërtetim pronësie
6	Gladiola Nue Musteqja	2537	68/43	200	354	70800	20000	90800	Vërtetim pronësie
7	Elida Nue Shkreta (Musteqja)	2537	68/45	150	354	53100	15000	68100	Vërtetim pronësie
8	Brikena Shijaku Musteqja	2537	68/47	135	354	47790	13500	61290	Vërtetim pronësie
9	Agetina Nue Curo (Musteqja)	2537	68/49	44	354	15576	4400	19976	Vërtetim pronësie
10	Sefer Shaban Dervishi & Shpresa Shaban Dervishi	2537	69/15	85	354	30090	8500	38590	Vërtetim pronësie
11	Agim Shaban Dervishi	2537	69/54	110	354	38940	11000	49940	Vërtetim pronësie
12	Muharrem Shaban Dervishi	2537	69/52	300	354	106200	30000	136200	Vërtetim pronësie
13	Arben Shaban Dervishi	2537	69/50	1473	354	521442	147300	668742	Vërtetim pronësie
	Shuma totale			5731				2 601 874	